

AKADEMIA "EVOLUCION"

STATUTI

Prishtinë
2023

PERMBAJTJA

1. DISPOZITAT E PERGJITHSHME	3
2. STRUKTURA ORGANIZATIVE	7
3. ORGANET UDHËHEQËSE.....	11
- Keshilli Drejtues	11
- Këshilli Akademik.....	13
- Këshilli i Sigurimit të Cilësisë i Akademisë “Evolucion”	15
- Këshilli Studentor.....	15
- Drejtori Ekzekutiv	16
- Dejtori Akademik	18
- Drejtori i Administratës	19
4. STAFI AKADEMIK DHE JOAKADEMIK	20
5. STUDENTET DHE ORGANIZIMI I STUDIMEVE	24
6. LLOJET E STUDIMEVE DHE KUSHTET PË RREGJISTRIM.....	27
7. PLANET DHE PROGRAMET STUDIMORE	28
8. PË RKAKTIMI I SUKSESIT AKADEMIK	29
9. TITUJT AKADEMIK DHE DIPLOMAT	30
10. KONTROLLI I CILËSISË DHE VETËVLERËSIMI.....	32
11. FINANCIMI	33
12. DISPOZITAT KALIMTARE	34

Në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, aktet tjera juridike të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), me të cilat rregullohet Arsimi i lartë në Republikën e Kosovës, Keshilli Akademik (në tekstin e mëtejme: "BiD") i Akademisë "Evolucion" në takimin e mbajtur në Prishtinë më 26.11.2022 miratoi ndryshimet si vijon:

STATUTI

I AKADEMISË “EVOLUCION”

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Statuti i Akademisë “Evolucion” (në tekstin e mëtejme: “Statuti”) rregullon misionin, qeverisjen, veprimtarinë dhe punën e Akademisë “Evolucion”. Ky Statut poashtu rregullon organizimin, autorizimet dhe mënyrën e vendosjes së organeve të Akademisë “Evolucion”, zhvillimin e studimeve, statusin e personelit akademik, administrativ dhe të studentëve, çështjen e marrjes së masave dicitpline dhe çështje të tjera të rëndësishme për Akademinë “Evolucion”.

Neni 2

Akademia “Evolucion” është bartës privat i arsimit të lartë në Kosovë, i cili organizon dhe zhvillon studime të larta profesionale dhe veprimtari komerciale në lëminë e arteve të aplikuara dhe dizajnit.

Selia, struktura dhe simbolet

Neni 3

Selia e Akademisë “Evolucion” është në adresën: Lagja Kalabria, rruga “Shefqet Shkupi”, p.n., 10000 Prishtinë.

Neni 4

Akademia "Evolucion" përbëhet nga departamentet dhe njësitë tjera organizative, siç parashihet më tej në këtë Statut.

Neni 5

Akademia "Evolucion" ka stemën, vulën dhe vulën e thatë.
Formën e stemës së Akademisë "Evolucion" e zgjedhë Keshilli Drejtues i Akademisë "Evolucion" (më tej: Keshilli Drejtues) me vendim të veçantë.
Vula dhe vula e thatë kanë formën e rrumbullakët dhe në mes kanë stemën e Akademisë "Evolucion".
Akademia "Evolucion" ka përvjetorin e tij. Data e këtij përvjetori është 14.09.2005 (data e mbajtjes së mbledhjes themeluese të Akademisë "Evolucion").

Misioni i Akademisë "Evolucion"

Neni 6

Misioni

AE krijon dhe kujdeset për një kulturë të veçantë, nxit procese inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështet rritjen ekonomike në vend dhe jo vetëm, dhe plotëson nevojat e një komuniteti divers/gjithë për rrethet duke rritur dhe forcuar partneritetet me bizneset dhe arsimin e lartë si brenda dhe jashtë vendit.

Vizioni

Të sigurojë një edukim të nivelit të lartë duke ofruar një ndjenjë humanizmi, krijimtarije dhe komunikimi të gjeneratave të reja për zhvillimin e vlerave, sistemeve dhe shoqërive të ndryshme.

AE do të njihet për:

Edukim ndërdisiplinor, eksperimental, i individualizuar dhe inovativ i fokusuar në zhvillimin personal dhe profesional të studentëve të pasionuar, punëtorë, ambiciozë dhe krijues të të gjitha moshave;

- Avokimi i AE për artin, dizajnin dhe sipërmarrjen krijuese;
- Diversiteti, qasshmëria dhe barazia e AE'së në gjithçka që bëjmë;

dhe shërbimi i AE'së për komunitetin tonë në vënd, rajon dhe më gjërë .

Objektivat kryesore të Akademisë "Evolucion" janë:

- Të afirmohet si institucion i vlerësuar i arsimit të lartë në Kosovë dhe më gjerë, i njohur për zhvillimin dhe avancimin e ideve të reja krijuese, ideve shkencore dhe arsimimit të gjithmbarshëm;
- Të zhvillojë dhe të zgjerojë vazhdimisht veprimtarinë e vet mësimore në përputhje me standardet bashkëkohore në fushën e arsimit të lartë profesional;
- Të arrijë nivel sa më të lartë profesional të arsimimit të specialistëve në fushën e artit aplikativ, dizajnit, shkencës dhe kulturës nëpërmjet të një procesi të gjithanshëm të mësimdhënies, hulumtimeve, aktiviteteve artistike dhe projekteve kreative;
- T'i ofrojë tregut vendor dhe të rajonit profesionistë të kualifikuar në fushën e arteve të aplikuara dhe dizajnit në pajtim me zhvillimet ekonomike, si dhe industriale në rajonale dhe më gjerë;
- Të ndihmojë në avancimin dhe forcimin e pozitës së vajzave, grave dhe grupeve të marginalizura në shoqëri;
- Të forcojë vetëdijen e përgjegjësisë sociale të stafit dhe studentëve dhe të vazhdojë të jetë kontribues i rëndësishëm në aktivitetet me interes të komunitetit.
- Të jetë një zë i fuqishëm në mbrojtje të kauzave, dukurive dhe grupeve të marginalizuara etj.,

Neni 7

Personeli i Akademisë "Evolucion" dhe studentët gëzojnë lirinë e organizimit dhe të tubimit në pajtim me ligjet në fuqi, Statutin dhe aktet tjera të Akademisë "Evolucion".

Neni 8

Akademia "Evolucion" ofron mundësi të barabarta për të gjithë, pa diskriminim në bazë gjinie, race, religjioni, besimi politik, përkatësie kombëtare, etnike ose sociale, pasurie, statusi të lindjes apo ndonjë statusi tjetër.

Neni 9

Akademia "Evolucion" gëzon liri akademike dhe autonomi organizative dhe financiare.

Liria akademike në mësimdhënie nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit profesional. Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet dhe programet mësimore të miratuara për të gjitha degët e studimeve që ka Akademia "Evolucion".

Në kuadrin e autonomisë organizative e financiare, Akademisë "Evolucion" i njihet e drejta e vendosjes së marrëdhënieve me institucione të arsimit të lartë të vendit dhe të huaja, e drejta e anëtarësimit në shoqata e organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, e drejta e bashkëveprimit me fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë, e drejta e disponimit të mjeteve sipas ligjit në fuqi, e drejta e administrimit të pasurisë, e drejta e përzgjedhjes së organeve drejtuese të departamenteve, e drejta e emërimit të personelit të Akademisë "Evolucion", e miratimit të të gjitha rregulloreve të mbrendshme të Akademisë "Evolucion", e miratimit të planeve dhe programeve mësimore, e përcaktimit të modalitetëve të pranimit të studentëve të rinj.

Neni 10

Akademia "Evolucion" është person juridik dhe gëzon të drejtat dhe obligimet nga ky kontekst, duke përfshirë edhe:

- të drejtën për të paditur dhe të drejtën për t'u paditur;
- të drejtën të përdorë vulën dhe emblemat tjera;
- të drejtën të kufizojë përdorimin e titullit të saj vetëm për personat dhe organizatat që e kanë autorizimin e saj.

Neni 11

Të gjitha mjediset (ndërtimet dhe trojet) që janë në administrim të Akademisë "Evolucion", si dhe çdo mjedis i fituar në mënyrë të ligjshme në të ardhmen, gëzojnë paprekshmërinë. Kjo paprekshmëri përfshinë mosndërhyrjen në mjediset e Akademisë "Evolucion" të çdo personi fizik dhe juridik (shtetëror apo privat), mosndërhyrjen e pushtetit dhe organeve të rendit pa lejen apo kërkesën e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë "Evolucion" (më tutje: Drejtori Ekzekutiv) ose personit të autorizuar prej tij.

Përfundimisht, për rastet e kryerjes së një krimi të rëndë dhe në rastet e fatkeqësisë natyrore, ndërhyrja e forcave të policisë dhe rendit mund të bëhet edhe pa lejen e Drejtorit Ekzekutiv.

Për çdo cenim të paprekshmërisë, Akademia "Evolucion" ka të drejtë të denoncimit të shkeljes dhe ndëshkimit të shkelësve sipas dispozitave ligjore.

2. Struktura organizative

Neni 12

Akademia "Evolucion" përbëhet prej:

1. Njësive akademike dhe
2. Administratës (Njësive organizative).

Neni 13

Njësitë akademike ose organizative nuk kanë subjektivitet juridik

1. Njësitë akademike

Neni 14

Njësitë akademike të Akademisë "Evolucion" janë:

1. Departamenti i Dizajnit të Modës, niveli Bachelor dhe Master
2. Departamenti i Dizajnit të Komunikimit

Në të ardhmen mund të themelohën edhe njësi tjera akademike.

Neni 15

Njësitë akademike kanë status të njëjtë sipas dispozitave që rregullojnë organizimin në këtë Statut.

Neni 16

Çdo njësi akademike ka emrin e vet.

Njësia akademike mbanë emblemën dhe emrin e Akademisë "Evolucion" brenda emblemës si dhe emrin e vet.

Neni 17

Njësitë akademike, në përputhje me madhësinë e vet, me numrin e përgjithshëm të personelit akademik, numrin e mësimdhënësve sipas fushave akademike si dhe përqindjen e personelit të përhershëm, duhet të plotësojnë standardet ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë profesional, në mënyrë që të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm dhe veprimtari profesionale në fushat përkatëse për një periudhë afatgjatë.

Keshilli Drejtues i Akademisë "Evolucion" nxjerr rregullore mbi organizimin e mbrendshëm të njësive akademike me propozim të departamenteve përkatëse.

Neni 18

Çdo departament është përgjegjës:

- të organizojë mësimdhënien, provimet dhe vlerësimin e studentëve;
- të sigurojë cilësinë, vlerësimin si dhe të raportojë përkitazi me këto çështje në pajtim me këtë Statut;
- të rregullojë çështjet e personelit sipas dispozitave të këtij Statuti;
- t'i paraqesë propozime dhe kërkesa Këshillit Akademik të Akademisë "Evolucion" përkitazi me çështjet akademike dhe ato që kanë të bëjnë me lëndët që ligjërohen në departament;
- të zhvillojë projekte apo krijimtari të shkathtësisë sipas standardeve ndërkombëtare;
- të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet, siç është paraparë me këtë Statut.

Neni 19

Çdo departament udhëheqet nga Udhëheqësi i tij.

Udhëheqësit e departamenteve zgjedhen/emërohen nga Këshilli Akademik për një periudhë tre vjeçare dhe duhet të posedojnë aftësi dhe përvojë në udhëheqje.

Neni 20

Udhëheqësi i departamentit mund të zëvendësohet para kohe në rast të:

1. dorëheqjes;
2. shkarkimit;
3. arsyeve shëndetësore;
4. dënimit për vepër penale;
5. vdekjes.

Procedura për shkarkimin e përgjegjësit mund të inicohet nga:

1. Këshilli Drejtues ;
2. Këshilli Akademik;
3. Drejtori Ekzekutiv;
4. Departamenti përkatës.

Procedura për shkarkimin e Udhëheqësit të Departamentit përcaktohet me rregulloret e nxjerra nga Këshilli Akademik i Akademisë "Evolucion" si dhe në përputhje me aktet dhe kontratat në fuqi.

Neni 21

Udhëheqësi i Departamentit i përgjigjet Drejtorit Akademik. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

- të sigurojë udhëheqje akademike në fushat përkatëse për zhvillimin e mësimit, punës mësimore, kërkimore dhe artistike në Departament;
- të ndërmer masa të nevojshme në zbatimin e vendimeve dhe detyrave të përcaktuara nga Këshilli Akademik;
- t'i sigurojë informata të mjaftueshme Drejtorit Akademik dhe Këshillit Akademik në lidhje me sigurimin e mjeteve dhe rezultateve në mësim, në krijimtari dhe shkathtësi sipas dispozitave të këtij Statuti;
- të përfaqësojë departamentin në Këshillin Akademik;
- të këshillojë Drejtorin Akademik dhe Këshillin Akademik për emërimin e personelit akademik për lëndët e departamentit;
- të kryejë detyra tjera të udhëheqësit të parapara me këtë Statut dhe me aktet tjera në fuqi.

2. Njësitë organizative

Neni 22

Njësitë organizative funksionojnë në kuadër të Akademisë "Evolucion" duke ofruar shërbime mbështetëse për punë mësimore, kërkimore dhe të shkathtësisë, si dhe shërbime administrative për njësitë akademike të Akademisë "Evolucion", të cilat janë të nevojshme për përmbushjen në mënyrë efektive dhe të dobishme të përgjegjësive dhe detyrave të shkollës të parapara me këtë Statut.

Neni 23

Administrata e Akademisë "Evolucion" përbëhet nga këto Departamente:

- Zyra për përkrahje të studentëve & regjistrime (PSR),
- Zyra për sigurimin e cilësisë (ZSC),
- Departamenti i financave,
- Zyra për orientim në karrierë & Alumni (ZOKA), dhe
- Departamenti i përkrahjes teknike.

Në të ardhmen, sipas nevojës mund të themelohen edhe njësi tjera organizative.

Neni 24

Çdo njësi organizative udhëheqet nga përgjegjësi i saj.

Neni 25

Udhëheqësit e Departamenteve dhe njësisë organizative emërohet nga Drejtori i Administratës dhe i përgjigjet atij/asaj për punën e njësisë/shërbimit.

Neni 26

Udhëheqësit e Departamenteve dhe Përgjegjësit e njësisë organizative kanë këto detyra:

- të udhëheqë njësinë organizative/departamentin për përmbushjen e objektivave nga fushëveprimi i saj;
- të përkujdeset për shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe efektiv të mjeteve të njësisë;
- t'i raportojë rregullisht Drejtorit të Administratës për ecurinë e punës;
- të këshillojë Drejtorin e Administratës për emërimin e anëtarëve të personelit të njësisë;
- të kryejë detyra të përgjegjësit të parapara me këtë Statut.

3. Organet Udhëheqëse të Akademisë “Evolucion”

Neni 27

Organet kryesore udhëheqëse të Akademisë “Evolucion” janë Keshilli Drejtues dhe Këshilli Akademik.

Të gjitha organet udhëheqëse të Akademisë “Evolucion” ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi parimin e votimit me shumicë votash nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Statut.

Neni 28

Drejtori Ekzekutiv është drejtues kryesor akademik e administrativ dhe përgjegjës për udhëheqjen e Akademisë “Evolucion”. Në kuadër të detyrave të tij, Drejtori Ekzekutiv i përgjigjet Keshillit Drejtues të Akademisë “Evolucion” për punë efektive, të frytshme dhe ekonomike të Akademisë “Evolucion”. Drejtorin Ekzekutiv e ndihmon Drejtori Akademik dhe Drejtori i Administratës i Akademisë “Evolucion”, siç parashihet më tej në Statut.

I.Keshilli Drejtues

Neni 29

Këshilli Drejtues i Akademisë “Evolucion” (më tej: Këshilli Drejtues) është organ kryesor qeverisës i Akademisë “Evolucion”.

Këshilli Drejtues përbëhet prej shtatë anëtarëve me të drejtë vote.

Pronarët e Akademisë “Evolucion” zgjedhin katër anëtarë të Keshillit Drejtues .

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë “Evolucion” është anëtar i Keshillit Drejtues me të drejtë vote.

Këshilli Akademik zgjedh një anëtar të Këshillit Drejtues me të drejtë vote nga personeli akademik i Akademisë "Evolucion".

Parlamenti i studentëve zgjedh dy anëtarë të Këshillit Drejtues me të drejtë vote radhët e studentëve aktivë të Akademisë "Evolucion".

Drejtori i Administratës është anëtar ex-officio i Këshillit Drejtues pa të drejtë vote.

Neni 30

Kryesuesi i Këshillit Drejtues zgjedhet me shumicë votash nga radha e anëtarëve të zgjedhur të Akademisë "Evolucion". Kryesuesi ka zëvendëskryesuesin.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjatë tre vjet me mundësi vazhdimi.

Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nevojitet kuorumi prej pesë anëtarëve.

Vendimet e Këshillit Drejtues me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se numri i votave është i barabartë, mbizotëron vota e kryesuesit.

Neni 31

Këshilli Drejtues ka këto përgjegjësi:

- miraton karakterin akademik dhe misionin e Akademisë "Evolucion", të propozuar nga Këshilli Akademik apo në konsultim me të, dhe sipas nevojës edhe me ekspertë-këshilltarë të jashtëm, si dhe të mbikëqyrë në vazhdimësi veprimtarinë e Shkollës;
- mbikëqyrë afarizmin e Akademisë "Evolucion" dhe shfrytëzimin e efektshëm dhe rritjen e vlerës së aseteve të saj;
- vendosë në lidhje me themelimin, shuarjen dhe ndryshimin e strukturës së brendshme të njësive akademike dhe njësive organizative në bazë të konsultave me Drejtorin Ekzekutiv, Drejtorin Akademik dhe Këshillin Akademik;
- vendosë për strukturën e përgjithshme organizative të njësive akademike, sipas propozimit të Këshillit Akademik;
- përcakton strategjinë, politikën e zhvillimit dhe të financimit të Akademisë "Evolucion";
- zgjedh Drejtorin Ekzekutiv;
- vendosë për planin e biznesit, investimet dhe blerjen e paisjeve;
- miraton llogarinë përfundimtare të Akademisë "Evolucion";
- jep pëlqimin për pranimin e punëtorëve për vende të reja të punës;
- nxjerr rregulloren e punës së Këshillit Drejtues ;
- aprovon çmimet për regjistrimin dhe shkollimin e studentëve;
- aprovon politikën e pranimin të studentëve të rinj;

- vendosë për koston e plotë ekonomike për dhënien e shërbimeve;
- sjell vendime që kanë për qëllim shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë të efektshme dhe të frytshme si dhe për ruajtjen e pronës së Akademisë "Evolucion";
- përcjell dhe mban evidencën e saktë të të dhënave mbi të hyrat dhe shpenzimet e Akademisë "Evolucion";
- nxjerr rregulloren për masat dhe procedurën diciplinore në Akademinë "Evolucion";
- në pajtim me këtë Statut mund të formojë komisione, të cilat do të merren me çështje të veçanta nga fushëveprimi i tij;
- vendoë për formën dhe përmbajtjen e stemës, vulës së thatë, flamurit dhe simboleve tjera;
- kryen edhe punë të tjera në pajtim me Ligjin dhe më këtë Statut.

II.Këshilli Akademik i Akademisë "Evolucion"

Neni 32

Këshilli Akademik i Akademisë "Evolucion" (më tej: Këshilli Akademik) është organ, i cili vendosë për çështjet më të rëndësishme të Akademisë "Evolucion" në fushën e mësimit, krijimtarisë e shkathësisë.

Këshillin Akademik e përbëjnë;

- Drejtori Ekzekutiv;
- Drejtori Akademik;
- Udhëheqësit e të gjitha njësive akademike sipas këtij Statuti;
- një përfaqësues i mësimitdhënësve;
- dy përfaqësues të studentëve;

Drejtori i Administratës i Akademisë "Evolucion" është anëtar i përhershëm i Këshillit Akademik pa të drejtë vote.

Neni 33

Këshillin Akademik e kryeson Drejtori Akademik. Në raste të veçanta, në mungesë të Drejtorit Akademik, Këshillin Akademik mund ta kryesojë anëtar i autorizuar nga Drejtori Akademik.

Neni 34

Këshilli Akademik nxjerr rregulloren e punës së tij dhe rregulloren për procedurën e zgjedhjes së anëtarit në cilësinë e përfaqësuesit të studentëve. Drejtori Akademik cakton procedurat për mbledhjet e Këshillit Akademik dhe të komisioneve të tij.

Neni 35

Këshilli Akademik është përgjegjës:

- për çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me studimet dhe procesin e mësimdhënies në Akademinë "Evolucion";
- për zhvillimin e strategjisë së aktiviteteve në Akademinë "Evolucion" dhe për mjetet e nevojshme për t'i mbështetur ato si dhe ofrimin e këshillave për Drejtorin Ekzekutiv dhe Këshillin Drejtues ;
- i propozon Këshillit Drejtues Statutin e Akademisë "Evolucion" për miratim;
- zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues nga radhët e veta;
- vendosë për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe artistike të Akademisë "Evolucion";
- propozon lartësinë e pagesave nga neni 31 i këtij Statuti;
- cakton kriteret e pranimit të studentëve;
- përkujdeset për sigurimin e cilësisë në bashkëpunim me Komisionin për sigurimin e cilësisë dhe përcakton procedurën e dhënies së kualifikimeve;
- propozon formën dhe përmbajtjen e stemës, vulës dhe vulës së thatë;
- miraton rregulloren mbi procedurën për shqyrtimin e masave ndaj studentëve;
- shqyrton çështjet e mbrojtjes së të drejtave të personelit dhe të studentëve;
- zbaton procedurën e zgjedhjes së personelit akademik në bazë të Statutit;
- shqyrton çështjet me kërkesë të parlamentit të studentëve;
- miraton ose kthen për përmirësim propozimet e planeve mësimore nga departamentet përkatëse dhe siguron që planet mësimore të jenë gati para se të fillojë viti akademik;
- kryen edhe punë të tjera të caktuara me këtë Statut.

Neni 36

Këshilli Akademik mund të formojë këshilla ose komisione të përkohshme për të këshilluar atë lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.

Këshilli Akademik ka një komision të përhershëm, të quajtur Komisioni për Sigurimin e Cilësisë.

III. Këshilli i Sigurimit të Cilësisë i Akademisë “Evolucion”

Neni 37

Këshilli i Sigurimit të Cilësisë në Akademinë “Evolucion” është përgjegjës për rishikimin dhe zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë në të gjithë institucionin, implementimi i të cilave monitorohet nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë së Akademisë “Evolucion”.

Objektivi kryesor i Këshilli i Sigurimit të Cilësisë është që të sigurojë që me përpikshmëri të implementohen politikat, proceset dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë së Akademisë “Evolucion”.

Këshilli i Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga pesë anëtarë

- dy anëtarë propozohen nga Këshilli Akademik,
- dy anëtarët tjerë propozohen nga Dejtori Ekzekutiv dhe
- një anëtar përfaqëson Këshillin Studentor.

Anëtarët që propozohen nga Këshilli Akademik mund të vijnë nga radhët e stafit akademik, stafit hulumtues, personelit administrativ dhe praktikantëve të industrisë.

IV. Këshilli Studentor

Neni 38

Këshilli i studentëve është organizëm i pavarur i studentëve të Akademisë “Evolucion, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqëson interesat e tyre.

Ai realizon dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Akademisë “Evolucion”, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve.

Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe propozime për probleme me interes të përgjithshëm të Akademisë “Evolucion”, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, etj.

Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 3 (tre) vjet nga votat e studentëve, dhe për rrethet nga një përfaqësues për çdo program studimi dhe vit studimi.

V. Drejtori Ekzekutiv i Akademisë "Evolucion"

Neni 39

Drejtori Ekzekutiv është drejtues kryesor i Akademisë "Evolucion".

Drejtori Ekzekutiv organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Akademisë "Evolucion" dhe është përgjegjës për punën efektive e të rregullt të Akademisë "Evolucion" si dhe për menaxhimin e saj në suaza të politikës së përcaktuar nga Keshilli Drejtues.

Neni 40

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë "Evolucion" ka këto detyra dhe përgjegjësi :

- organizon, drejton dhe menaxhon Akademinë "Evolucion";
- vepron në emër të Akademisë "Evolucion" dhe e përfaqëson atë;
- drejton dhe zhvillon gjithë punën mësimore e shkencore-artistike në Akademinë "Evolucion";
- siguron shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe të dobishëm të mjeteve të Akademisë "Evolucion"
- përpilon raportin vjetor të buxhetit për të hyrat dhe shpenzimet për vlerësim dhe miratim nga Keshilli Drejtues ;
- organizon konkurset e pranimeve të studentëve të rinjë në Akademinë "Evolucion" dhe të mbikqyrë komisionin e pranimeve;
- zbaton vendimet e Keshillit Drejtues
- emëron personelin ndihmës mësimor, administrativ dhe teknik dhe nënshkruan kontratat e tyre të punës;
- nënshkruan kontratat e aktivizimit të personelit të jashtëm mësimor;
- shpallë fituesit e konkurseve të pranimit;
- kryen të gjitha detyrat e tjera në emër të Akademisë "Evolucion", siç janë përcaktuar me këtë Statut dhe rregulloret e tjera në fuqi.

Neni 41

Drejtorin Ekzekutiv e zgjedh Keshilli Drejtues .

Neni 42

Drejtori Ekzekutiv emërohet për një periudhë trevjeçare me mundësi vazhdimi.

Neni 43

Mandati i Drejtorit Ekzekutiv mund të përfundojë para kohe në rast të:

- dorëheqjes;
- shkarkimit nga detyra;
- arësyeve shëndetësore;
- dënimit për vepër penale;
- vdekjes.

Neni 44

Drejtori Ekzekutiv mund të formojë komisione këshilldhënëse të përkohshme për të përgatitur punët e caktuara nga fushëveprimi i vet.

Neni 45

1) Drejtorin Ekzekutiv e zgjedh Keshilli Drejtues në bazë të nje konkursi publik nga radhet e profesoreve te rregullt, profesoreve te asocuar ose te profesoreve asistente nga personeli i brendshëm apo nga personeli jashtë Akademisë Evolucion.

2) Drejtorin Ekzekutiv zgjidhet me shumicën e votave nga antarët e Keshillit Drejtues . Në rast se kandidatet e propozuar në rrethin e parë të votimit nuk fitojnë votat e nevojshme, atëherë dy kandidatet me numrin më të madh të votave kalojnë në rrethin e dytë të votimit, ku edhe zgjidhet kandidati që merr numrin më të madh të votave. Kandidatet duhen të jenë individë me kualifikime relevante akademike dhe të kenë aftësi për të udhëhequr Drejtorin Ekzekutiv emëruar për një periudhë trevjeçare me mundësi rizgjedhjeje.

Neni 45

Vendimin për shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv e merr Keshilli Drejtues me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet.

VI. Drejtori Akademik i Akademisë "Evolucion"

Neni 46

Drejtori Akademik është drejtues kryesor akademik i Akademisë "Evolucion".

Drejtori Akademik organizon dhe drejton veprimtarinë akademike të Akademisë "Evolucion" dhe është përgjegjës për aktivitetet akademike, kërkimore dhe kreative në Akademinë "Evolucion".

Neni 47

Drejtori Akademik i Akademisë "Evolucion" ka këto detyra dhe përgjegjësi :

- organizon, drejton dhe menaxhon aktivitetet akademike të Akademisë "Evolucion";
- mbikqyrë punën mësimore e shkencore-artistike në Akademinë "Evolucion";
- organizon konkurset e pranimeve të studentëve të rinj në Akademinë "Evolucion" dhe mbikqyrë komisionin e pranimeve;
- shpallë fituesit e konkurseve të pranimit;
- kryen të gjitha detyrat e tjera në emër të Akademisë "Evolucion", siç janë përcaktuar me këtë Statut dhe rregulloret e tjera në fuqi.

Neni 48

Drejtorin Akademik e zgjedh Këshilli Drejtues .

Neni 49

Drejtori Akademik emërohet për një periudhë trevjeçare me mundësi vazhdimi.

Neni 50

Mandati i Drejtorit Akademik mund të përfundojë para kohe në rast të:

- dorëheqjes;
- shkarkimit nga detyra;
- arësyeve shëndetësore;
- dënimit për vepër penale;
- vdekjes.

Neni 51

Drejtori Akademik mund të formojë komisione këshilldhënëse të përkohshme për të përgatitur punët e caktuara nga fushëveprimi i vet.

Neni 52

Vendimin për shkarkimin e Drejtorit Akademik e merr Keshilli Drejtues me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet.

VII. Drejtori i Administratës i Akademisë "Evolucion"

Neni 53

Drejtori i Administratës është zyrtar më i lartë juridik, ekzekutiv dhe administrativ i Akademisë "Evolucion".

Drejtori i Administratës përgjigjet Drejtorit Ekzekutiv për administrim efikas, juridik, ekonomik dhe efektiv në të gjitha nivelet e Akademisë "Evolucion".

Drejtori i Administratës zgjidhet nga Keshilli Drejtues me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, sipas propozimit të Drejtorit Ekzekutiv, në bazë të konkursit publik.

Kandidatët që konkurojnë për postin e Drejtorit të Administratës të Akademisë "Evolucion" duhet të kenë diplomë universitare dhe përvojë pune në punët e ngjajshme.

Neni 54

Drejtori i Administratës i Akademisë "Evolucion" ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- është zyrtari më i lartë i administratës së Akademisë "Evolucion";
- është zyrtar përgjegjës për udhëheqje efikase, juridike, ekonomike dhe efektive të Akademisë "Evolucion";
- është përgjegjës për përgatitje teknike të procesit buxhetor;
- është përgjegjës për koordinimin e punës së Komisionit për sigurimin e Cilësisë;
- është përgjegjës për menaxhimin e objektit dhe orarit të mësimin;
- është përgjegjës për mbajtjen e evidencës së rregullt për kandidatët që paraqiten për praninë; studentët e regjistruar në të gjitha drejtimet e Akademisë "Evolucion"; të

diplomuarit, personelin me kontratë; pronën; ndërmarrjen e masave për përparimin e punës së shërbimeve të administratës së Akademisë "Evolucion"; dhënien e mendimeve dhe përgatitjen e akteve të përgjithshme të Akademisë "Evolucion" dhe të departamenteve;

- koordinon aktivitetet e marketingut të shkollës në bashkëpunim me stafin tjetër;
- kryen edhe punë të tjera të parapara me këtë Statut dhe ligj.

4. Staf i akademik dhe joakademik

Neni 55

1. Të gjitha vendet e punës në Akademinë "Evolucion" bazohen në kontratat me normë të plotë dhe kontratat me gjysmënormë.
2. Këshilli Drejtues nxjerr rregullore të veçanta për kontratat për personelin akademik dhe joakademik në përputhje me rregulloret e brendë shme dhe ligjet në fuqi.

1. Staf i akademik

Neni 56

Në Akademinë "Evolucion" veprimtarinë mësimore, shkencore dhe profesionale e zhvillon personeli akademik.

1. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet apo Institucion tjetër të Arsimit të Lartë .
2. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune, i cili mund të jetë i angazhuar, zgjedhur apo emruar në ndonjë institucion tjetër publik nuk ka të drejtë për t'u zgjedhur në organe drejtuese.

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ 15/2018, personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Akademinë Evolucion duhet të ketë vetëm një marrëdhënie të rregullt pune, qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

1.1. Thirrjet dhe procedura e zgjedhjes së personelit akademik

Neni 57

Përsonei akademik përbëhet nga:

1. Profesor e rregullt
2. Ligjërues
3. Ligjërues Mësimdhënësit bashkëpunëtorë (të jashtëm);
4. Asistentët.

Thirrjet akademike rregullohen me rregullore të vecantë .

Neni 58

Zgjedhja e personelit akademik bëhet në mënyrë transparente në bazë të konkursit publik. Konkursin për zgjedhje të personelit akademik e shpallë Këshilli Akademik në bazë të propozimeve të udhëheqësve të departamenteve dhe Një sive Akademike.

Konkursi zgjat 15 dite.

Neni 59

Pas mbylljes së konkursit, Këshilli Akademik formon komisionin profesional prej së paku tre anëtarësh për propozimin për zgjedhje në thirrje të caktuar.

Anëtar i komisionit profesional nuk mund të jetë personi, i cili është bashkëshort, partner ose anëtar i familjes së ngushtë të kandidatit që duhet të zgjidhet.

Këshilli Akademik përcakton propozimin për një nga kandidatët, i cili i plotëson më së miri kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkurs për zgjedhje. Propozimi për zgjedhjen e personelit akademik i dërgohet Këshillit Akademik, i cili bën zgjedhjen, ndërsa kontratën e punës e lidhë Drejtori i Administratës në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për periudhën për të cilën është zgjedhur.

Neni 60

Kriter për zgjedhjen dhe avancimin e çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës të rregulluar në rregulloren për avancim.

Neni 61

Zgjedhja në thirrje avancimi të personelit akademik bëhet në kohëzgjatje prej tri vitesh. Ajo mund të përsëritet me rekomandimin e Këshillit Akademik.

1.2. Lidhja dhe shkëputja e kontratës me personelin akademik

Neni 62

Personeli akademik konsiderohet i punësuar në Akademinë "Evolucion", pasi të jetë kryer procedura e zgjedhjes, me nënshkrimin e kontratës së punës me Drejtorin Ekzekutiv të Akademisë "Evolucion", në bazë të Ligjit të Punës në fuqi, kontratës kolektive dhe këtij Statuti.

Neni 63

Kontrata e punës me personelin akademik mund të ndërpritet para kohe në rast:

- dorëhëqjes me shkrim të personelit akademik sipas procedurës dhe afatit të paraparë me kontratën e punësimit;
- dënimi për vepër penale, me të cilën cenohet imazhi i Akademisë "Evolucion", sipas procedurës së përcaktuar me rregullore të veçantë të Akademisë "Evolucion";
- të shkeljes së rëndë të Kodit të Etikës së personelit akademik, në bazë të procedurës së parashikuar me atë kod;
- të paaftësisë për të ushtruar detyrën për shkaqe fizike ose mentale, të dëshmuar me raport të mjekut;
- se me sjellje të tij/saj e cenon rendin, autoritetin dhe dinjitetin e Akademisë "Evolucion", sipas procedurës së parashikuar me rregullore të veçantë;
- për sjellje ose vepër korruptive, të përcaktuar sipas procedurës së parashikuar me rregullore dhe ligj.

1.3. Procedura disiplinore

Neni 64

Personeli akademik i Akademisë "Evolucion", në punën, veprimtarinë dhe sjelljet e veta duhet t'i përshtatet parimeve morale dhe etike, parimeve të së vërtetës shkencore dhe artistike dhe ta mbrojë autoritetin e Akademisë "Evolucion" në mënyrën e paraparë me etikën e personelit akademik.

Neni 65

Cenimi i rregullave të sjelljes dhe mos kryerja e obligimeve të përcaktuara me këtë Statut, me Kodin e Etikës dhe me aktet e tjera të Akademisë "Evolucion" nga personeli akademik dhe nga personat tjerë të punësuar në Akademinë "Evolucion", tërheq përgjegjësinë disiplinore. Procedura disiplinore përcaktohet me Rregulloren mbi procedurën disiplinore të Akademisë "Evolucion", të cilën e nxjerr Këshilli Akademik në pajtim me ligjin, në pajtim me këtë Statut, me kodin e mirësjelljes dhe akteve të tjera të Akademisë "Evolucion".

2. Staf i joakademik

Neni 66

Në personelin joakademik të Akademisë "Evolucion" bëjnë pjesë personat që angazhohen për:

1. Detyra udhëheqëse dhe profesionale;
2. Administratë;
3. Punë teknike.

Përgjegjësitë dhe kualifikimet e veçanta për çdo pozicion përcaktohen me përshkrimin e punës të caktuar nga Drejtori Ekzekutiv me propozimin e Drejtorit të Administratës ose nga përgjegjësi i njësisë akademike apo organizative.

Neni 67

Titujt e nderit, çmimet dhe mirënjohjet e Akademisë "Evolucion"

1. Akademisë "Evolucion" u ndanë titujt e nderit personave të merituar. Kë shilli Akademik do të nxjerrë rregullore të veçantë për procedurën e vendimmarrjes në përzgjedhjen e titujve të nderit, çmimet për student të dalluar dhe mirënjohjet.

Neni 68

1. Titulli "Anëtar Nderi i Akademisë "Evolucion" i jepet për:
 1. Përkrahje të pandërprerë të brendshme dhe për përkrahjen politike për Akademisë "Evolucion";
 - 1.2. Kontribut relevant financiar në zhvillimin e Akademisë "Evolucion".

5. Studentët dhe organizimi i studentëve

Neni 69

Student i Akademisë "Evolucion" është personi i regjistruar në Akademinë "Evolucion", i cili i plotëson detyrimet e veta akademike dhe financiare në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, aktet tjera juridike të MASHT si dhe aktet e përgjithshme të Akademisë "Evolucion". Statusin e vet studentit e dëshmon me indeks ose me dokument tjetër të parashikuar me aktet e përgjithshme të Akademisë "Evolucion".

Neni 70

Studenti duhet t'i plotësojë detyrimet e veta akademike dhe financiare të parapara me ligj, me këtë statut dhe me akte tjera të përgjithshme.

Neni 71

Studimet mund të vijohen në mënyrë të rregullt, ashtu siç parashihet me Statutin e Akademisë "Evolucion" dhe me rregulloren e tij.

1. Regjistrimi në studime

Neni 72

Pranimi në studime në Akademinë "Evolucion" bëhet në bazë të konkursit publik, në bazë të procedurës përzgjedhëse dhe kritereve të vlerësimit të përcaktuara nga Këshilli Akademik.

Neni 73

Vendimin për shpalljen e konkursit për pranim të studentëve e merr Këshilli Akademik me propozimin e departamenteve përkatëse.

Neni 74

Studenti fiton të drejtën e regjistrimit në vitin më të lartë të studimeve në qoftë se i kryen të gjitha detyrimet e përcaktuara me planin dhe programin mësimor, Rregulloren mbi studimet dhe aktet tjera të përgjithshme.

Studenti mund të regjistrojë sërish të njëjtin vit të studimeve sipas kushteve të përcaktuara me Rregulloren mbi studimet, pas përmbushjes së detyrimet financiare ndaj Akademisë "Evolucion".

Neni 75

Studenti duhet t'i mbarojë studimet themelore akademike brenda periudhës kohore që nuk tejkalon dyfishin e periudhes normale të paraparë për studimet, të cilat i ka regjistruar. Përjashtim bëjnë rastet e veçanta, për të cilat vendosë Këshilli Akademik.

Neni 76

Studenti humb statusin e studentit:

- kur përfundon studimet;
- nëse çregjistrohet;
- nëse nuk regjistrohet në vitin më të lartë ose në të njëjtin vit të studimeve;
- me vendim nga procedura disiplinore;
- nëse nuk i kryen studimet në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin paraprak të këtij Statuti;

2. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 77

Studentët kanë të drejtë:

- të marrin pjesë në ligjërata, seminare dhe aktivitete tjera mësimore;
- të përdorin literaturën, instalimet dhe pajisjet e Akademisë "Evolucion" për plotësimin e punës së tyre mësimore-shkencore e artistike, sipas programeve dhe rregulloreve përkatëse;
- të përdorin bibliotekën dhe mjediset tjera të Akademisë "Evolucion";
- të marrin pjesë në zgjedhjet për postet e studentëve në organizmat e ngritura në bazë të statutit dhe akteve tjera përkatëse;
- të ushtrojnë anëkesë lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose lidhur me lokalet në të cilat mbahet mësimi;
- të drejtat të tjera të parapara me këtë Statut dhe aktet tjera të Akademisë "Evolucion".

Neni 78

Studentët kanë këto detyrime:

- të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga planet mësimore;
- të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga Akademia "Evolucion";
- të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- të ruajnë prestigjin dhe dinjitetin e Akademisë "Evolucion";
- detyrimet të tjera të parapara me këtë Statut dhe aktet e tjera të Akademisë "Evolucion".

Neni 79

Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore, të cilave mund t'u përkasin të gjithë studentët.

Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të Akademisë "Evolucion" me këto organe:

1. Parlamenti i studentëve në nivel të Akademisë "Evolucion";
2. Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike.

Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve të njësisë akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.

Neni 80

Në rast të shkeljes së detyrimeve të studentit, kundër tij mund të ngrihet procedura disiplinore në bazë të rregullores së posaçme të Akademisë "Evolucion".

Masa më e lehtë disiplinore është vërejtja me shkrim, kurse masa më e ashpër është përjashtimi i përhershëm nga Akademia "Evolucion".

6. Llojet e studimeve dhe kushtet për regjistrim

Neni 81

Studimet në Akademinë "Evolucion" përcaktohen në kuadër të programeve të studimeve.

Përmbajtja e programeve të studimeve për mësimëdhënie përcaktohet me rregulloret e përgatitura nga komisioni akademik i departamentit përkatës dhe aprovet nga Këshilli Akademik.

Neni 82

Akademia "Evolucion" ofron këto lloje të studimeve themelore:

- a) Studime të nivelit të gjashtë (Bachelor),
- b) Studime të nivelit të shtatë (Master),
- c) Kurse të shkurtëra profesionale.

Neni 83

Studimet themelore te nivelit Bachelor 3 (tre) vjet dhe me këtë studentët fitojnë përgatitje themelore profesionale dhe marrin diplomën Bachelor nga fusha përkatëse e studimeve dhe 2 (dy) vjet ne nivelin Master dhe me këtë studentët fitojnë përgatitje të lartë profesionale dhe marrin diplomën Master nga fusha përkatëse e studimeve.

Neni 84

Kushtet për pranim në studimet themelore në Akademinë "Evolucion" janë:

- Përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Republikën e Kosovës i vërtetuar me diplomë;

- Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit i vërtetuar me diplomë përkatëse;
- Autorizim i veçantë i lëshuar nga ana e MASHT.

Çdo student duhet të kalojë me sukses provimin pranues për regjistrim në vitin e parë të studimeve. Në rast kur nuk aplikohet provimi pranues por intervista dhe portofolioja artistike, atëherë për pranim vendosë paneli intervistues i përbërë nga anëtarë të deleguar të Këshillit Akademik.

7. Planet dhe programet mësimore

Neni 85

Me planet dhe programet mësimore përcaktohen në hollësi kushtet, të cilat duhet të plotësohen për çdo lloj të studimeve.

Neni 86

Planet dhe programet mësimore i miraton Këshilli Akademik me propozim të departamenteve përkatëse.

Neni 87

Planet dhe programet mësimore përmbajnë lëndët obligative dhe zgjedhore, të cilat më hollësisht rregullohen me rregulloren e Akademisë "Evolucion".

Neni 88

Me rastin e përcaktimit të planit mësimor, Akademia "Evolucion" duhet posaçërisht të kujdeset që studimi të jetë:

- bashkëkohor dhe që i përshtatet mundësive dhe interesave të studentëve;
- në harmoni me standardet e përcaktuara nga MASHT;
- i krahasueshëm me institucionet e tjera të larta arsimore në vend dhe jasht vendit, me qëllim të ofrimit të mundësisë së bartjes së kredive në institucionet tjera arsimore brenda dhe jasht vendit sipas Sistemit European të Transferit të Kredive (ECTS).

Çdo mësimdhënës është i obliguar që të bashkëpunojë me stafin dhe udhëheqësin e departamentit përkatës në përpilimin e programit të lëndës së vet. Ky plan duhet të miratohet nga Këshilli Akademik. Pas miratimit, në fillim të vitit akademik, ky plan u shpërndahet studentëve përkatës.

Neni 89

Departamentet e Akademisë "Evolucion" në fillim të çdo viti akademik e bëjnë listën e mësimdhënësve dhe bashkëpunorëve për tërë vitin akademik sipas planit mësimor.

Neni 90

Viti akademik fillon më 1 tetor të vitit vijues dhe përfundon më 30 shtator të vitit të ardhshëm. Mësimi organizohet në dy semestra (semestri dimëror prej datës 1 tetor deri më 15 shkurt dhe semestri veror prej datës 01 mars deri më 15 qershor të vitit akademik).

8. Përcaktimi i suksesit akademik

Neni 91

Dija dhe shkathtësitë e fituara të studentit vlerësohen në mënyrë periodike gjatë tërë procesit të mësimimit, ndërsa nota definitive përcaktohet në provimin përfundimtar nga ana e mësimdhënësit të lëndës.

Provimet mbahen në të gjitha lëndët, të cilat studenti i ka regjistruar në bazë të materies së përcaktuar me programin mësimor.

Provimit mund t'i nënshtrohet studenti i cili kryen të gjitha obligimet e përcaktuara me këtë Statut dhe me aktet e tjera të Akademisë "Evolucion".

Suksesi i arritur në provim është publik.

Neni 92

Suksesi i studentit shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).

Nota 5 (pesë) shprehë suksesin e pamjaftueshëm dhe për të mbahet evidencë e posaçme.

Neni 93

Afatet e provimeve janë:

Afatet e rregullta: afati i janarit, qeshorit dhe ai i shtatorit.

Këto afate janë fikse dhe orari i tyre publikohet në fillim të çdo viti.

Afat i jashtëzakonshëm është afati i prillit, ndërsa për absolventët është edhe afati i nëntorit.

Dispozitat me detaje lidhur me provimet përcaktohen me rregulloren e veçantë të Akademisë "Evolucion"

9. Titujt profesionalë dhe diplomat

Neni 94

Sipas kushteve për akreditim të parapara me ligj, Akademia "Evolucion" jep këta tituj profesionalë dhe këto diploma:

- diplomë për studime themelore Bachelor (BA).
- diplomë për studime të larta Master (MA).

Neni 95

Vlerësimi për studime themelore Bachelor dhe Master bëhet sipas sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) në të gjitha departamentet e Akademisë "Evolucion". Studentëve i`u mundësohet bartja e kredive nga Akademia "Evolucion" në institucionet e tjera brenda vendit dhe jashtë tij.

Neni 96

Studentëve do t`u njihen kreditë e fituara edhe në kurset e akredituara nga ministrinë përkatëse. Në marrëveshje me stafin akademik të Akademisë "Evolucion", studentët kanë të drejtë të ndjekin lëndë të veçanta edhe ne institucionet të tjera publike dhe private të nivelit ekuivalent të licencuara nga MASHT dhe të akredituara nga Agjencioni i Akreditimit i Kosovës.

Neni 97

Diploma Bachelor jepet pas përfundimit të studimeve themelore akademike trevjeçare.

Neni 98

Të gjitha programet e studimeve themelore trevjeçare të Akademisë “Evolucion” përfundojnë me punimin e diplomës (disertacionit ose projektit final) për nivelin Bachelor ose me provim para komisionit në pajtim me programet e tyre të studimeve.

Punimi i diplomës (disertacionit ose projektit final) për nivelin Bachelor elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara.

Punimi i diplomës (disertacioni ose projekti final) për nivelin Bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet kontributi i secilit kandidat.

Neni 99

Diploma Master jepet pas përfundimit të studimeve të larta akademike dyvjeçare të nivelit Master.

Neni 100

Të gjitha programet e studimeve të larta dyvjeçare të nivelit Master të Akademisë “Evolucion” përfundojnë me punimin e diplomës (disertacionit ose projektit final) për nivelin Master ose me provim para komisionit në pajtim me programet e tyre të studimeve.

Punimi i diplomës (disertacionit ose projektit final) për nivelin Master elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara.

Punimi i diplomës (disertacioni ose projekti final) për nivelin Master mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet kontributi i secilit kandidat.

Neni 101

Mënyra, kushtet dhe procedura e provimit përcaktohen me rregullore të Akademisë “Evolucion”.

10. Kontrolli i cilësisë dhe vetëvlerësimi

Neni 102

Akademia "Evolucion" kontrollon dhe zhvillon sistemin e vet të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies dhe aktiviteteve krijuese dhe artistike. Kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë i nënshtrohet çdo segment i punës së Akademisë dhe ka për detyrë analizimin efikas të funksionimit të saj.

Neni 103

Puna e të gjithë personelit akademik dhe stafit profesional i nënshtrohet vlerësimit të vazhdueshëm. Vërtetimi dhe vlerësimi i rregullt i punës mësimore të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe stafit profesional në Shkollë bëhet një herë në vit. Vlerësimet e brendshme përmes vlerësimit vetanak realizohen në këtë mënyrë:

- a) përmes pyetësorëve dhe vetëvlerësimit nga ana e personelit akademik;
- b) përmes pyetësorëve anonimë të vlerësimit nga studentët;
- c) përmes analizës së parametrave të bazuar në raportet të punës dhe përmbushjes së detyrave, me ndihmën e të cilave njësisive të kontrolluara iu përcaktohen masat që duhet marrë për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë.

Neni 104

Vlerësimet udhëhiqen në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit. Përmes këtyre anketave secili student mund të vlerësojë punën e mësimdhënësve të vet ku parashihen: fushat e vlerësimit, objektivat, procedurat, oraret dhe instrumentet. Vlerësimet kanë këto efekte:

1. motivimin dhe vlerësimin publik në rast të rezultateve pozitive,
2. zbatimin e masave të përshtatshme me qëllim të përmirësimit të punës në rast të rezultateve negative.

Pas përfundimit të çdo vlerësimi përgatitet raporti me shkrim lidhur me procedurën e vlerësimit, rezultatet dhe masat e propozuara.

11. Financimi

Neni 105

Akademia "Evolucion" në përputhje me dispozitat e këtij Statuti siguron mjete financiare nga këto burime:

- nga tarifat e shkollimit, tarifat administrative dhe pagesat tjera që i bëjnë studentët;
- nga pagesat për shërbimet komerciale dhe shërbime tjera;
- nga fondet e Ministrisë dhe buxhetit të Republikës së Kosovës për mësimdhënie dhe kërkime shkencore-artistike me interes të përgjithshëm;
- nga donacionet, dhuratat dhe ndihmat;
- shfytëzimi i pronësisë intelektuale të Akademisë "Evolucion";
- nga kontratat me organizatat kombëtare, ndërkombëtare, publike ose private në fushën e mësimdhënies, kërkimeve shkencore, artistike;
- çdo lloj burimi tjetër i lejuar nga ligjet në fuqi të Kosovës.

Neni 106

Akademia "Evolucion" ka llogarinë rrjedhëse.

Mjetet e realizuara nga neni paraprak i këtij Statuti derdhen në llogarinë rrjedhëse të Akademisë "Evolucion".

Neni 107

Metodologjia e financimit, kushtet e tij dhe kontrolli financiar përcaktohen më hollësisht me rregulloren e Akademisë "Evolucion".

12. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 108

Rregulloret e veçanta të Akademisë “Evolucion” dhe aktet tjera të të organeve të saj hartohen në pajtim me ligjet në fuqi dhe me këtë Statut.

Neni 109

Statuti i Akademisë “Evolucion” mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të tij.

Statuti është miratuar nga Këshilli Akademik i AE-së .

Prishtinë , 2023